



Lidhja Demokratike e Kosovës

Pasqyrat Financiare Vjetoredhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar2014 - 31 Dhjetor 2014

Përmbajtja:

<u>Raport i auditorëve të Pavarur.....</u>	<u>3</u>
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Shënimet e pasqyrave financiare.....	7-16

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik “Lidhja Demokratike e Kosovës” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “LDK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2014, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 7-16.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2014, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 ,Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Siç paraqitet në shënimin 9 të pasqyrave financiare, Shpenzimet, subjekti politik ka Pagat dhe kompensimet në vlerë 270,533.73 EUR, ne mungese të dokumenteve mbështetëse, kontratave të punës, vendimet etj, ne duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit nuk ishim në gjendje të përfitojmë një siguri të arsyeshme në lidhje me tërësinë, ekzistencën dhe saktësinë e kësaj shume për periudhën e përfunduar më 31 dhjetor 2014.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ka kryer pagesa një marrësi të vetëm në vlerë mbi 5,000 EUR brenda një dite në kundërshtim me kërkesat ligjore të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, nëni 26 Detyrimet shpesh të partive politike.
- Subjekti Politik në blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedurë të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nëni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nëni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.
- Gjatë auditimit tone në kemi vërejtur që tek shpenzimet e reprezentacionit dhe karburantit , në disa raste SP nuk ka dokumentacion relevant mbështetës, përveç faturave, që do mundë të arsyetonin dhe mbështetnin shpenzimin e ndodhur.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me



qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit&Contosh.p.k

QerimQerimi
Auditor Ligjor
29Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	95,561.98	106,893.05
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		95,561.98	106,893.05
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	3	300.00	0.00
Parapagimet			
Paraaja dhe ekuivalentët e parasë	4	73,441.46	164,834.40
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		73,741.46	164,834.40
Total pasuritë		169,303.44	271,727.45
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		111,732.53	549,536.25
Suficiti / (deficiti) i vitit		(65,832.52)	(437,803.72)
Total Ekuiteti		45,900.01	111,732.53
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera		95,561.98	106,893.05
Gjithsej detyrimet afatgjata		95,561.98	106,893.05
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	5	23,084.65	15,140.25
Detyrimet tjera afatshkurtra	6	4,756.80	37,961.62
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		27,841.45	53,101.87
Gjithsej detyrimet		123,403.43	159,994.92
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		169,303.44	271,727.45

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2014	2013
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		908,636.00	803,787.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla	7	0.00	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	8	1,800.00	1,800.00
Të hyrat e fushatës		23,880.00	25,030.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	2	31,911.14	9,044.00
Të hyrat tjera		4,080.00	15,555.84
Gjithsej të hyrat për vitin		970,307.14	855,216.84
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	9	270,533.73	255,862.62
Shpenzimet e transportit	9	49,476.02	56,523.31
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	9	70,546.75	113,417.35
Shpenzimet e fushatës	9	493,555.84	768,691.76
Blerja e mallrave	9	9,935.59	21,070.20
Shpenzimet e përgjithshme	9	113,843.01	59,616.48
Shpenzimet e ndryshme	9	28,248.72	17,838.84
Gjithsej shpenzimet për vitin		1,036,139.66	1,293,020.56
Suficiti (deficiti) për vitin		(65,832.52)	(437,803.72)

1. Informata te përgjithshme

Lidhja Demokratike e Kosovës është partia e tretë më e madhe në Kosovë. Është një parti konservatore dhe liberale konservatore

Udhëheqja: Isa Mustafa (Kryetar i partisë)

Themelues: Ibrahim Rugova

Themeluar: 23 dhjetor 1989

Ideologjia: konservatizmi, neoliberalizmi, liberalizmi i tregut.

Pozita politike: Politika e qendrës së djathtë

Pasqyrat financiare te Lidhjes Demokratike te Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët

Subjekti Politik mirëmban vetëmnjëllogari te vetme bankare ne bankën NLB.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////		0.00
Objektet					0.00
Veturat	90,440.00		9,044.00	18,088.00	63,308.00
Pajisjet e zyrës	5,643.25	19,750.07		7,618.00	17,775.32
Pajisjet e teknologjisë informative	18,533.80	830.00		5,809.14	13,554.66
Pajisjet tjera	1,320.00			396.00	924.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	115,937.05	20,580.07	9,044.00	31,911.14	95,561.98

Shënimi 3. Llogaritë e arkëtueshme

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Llogaritë e arkëtueshme vendore	300.00	-
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme	300.00	-

Shënimi 4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Paraja në bankë	73,441.46	164,834.40
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	73,441.46	164,834.40

Shënimi 5. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Furnitor vendor	23,084.65	15,140.25
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	23,084.65	15,140.25

Shënimi 6. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	4,756.80	5,612.82
Detyrimet për qira		398.80
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		31,950.00
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	4,756.80	37,961.62

Shënimi 7: Donacionet dhe kontributet në të holla

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka pranuar donacione dhe kontribute në të holla gjatë vitit 2014.

Shënimi 8: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Qiraja e zyrave	Ismet Gashi	Rr e Shkodres-13-Prishtinë	1019463415	02.01.2014	1,800.00
Mobile	SM-Comerc	Arta-Emshirpn -Prishtinë		06.01.2014	7,841.07
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					9,641.07

Shënimi 9: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	234,072.59	234,072.59	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	11,624.22	10,525.01	1,099.21
Kontributet pensionale të punëdhënësit	11,624.22	10,525.01	1,099.21
Tatimet në të ardhura personale	13,212.70	12,083.45	1,129.25
Beneficionet tjera			0.00
Gjithsej	270,533.73	267,206.06	3,327.67

Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	29,655.70	27,631.70	2,024.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	14,080.55	14,080.55	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	5,169.77	5,049.77	120.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	570.00	570.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	49,476.02	47,332.02	2,144.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	232.00	232.00	0.00
Ushqimi	29,475.98	25,906.14	3,569.84
Aktivitete kulturore dhe rekreative	2,749.40	1,979.40	770.00
Radio dhe spotet televizive	5,500.00	5,500.00	0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	45.00	45.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	32,544.37	23,508.58	9,035.79
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	70,546.75	57,171.12	13,375.63
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	493,555.84	493,555.84	0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	493,555.84	493,555.84	0.00

Lidhja Demokratike e Kosoves

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor, 2014

Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	9,811.59	9,195.29	616.30
Pajisjet të vogla	124.00	124.00	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	9,935.59	9,319.29	616.30
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	55,912.12	1,429.13	55,912.12
Telefoni, interneti dhe posta	14,300.98	328.27	14,300.98
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	6,051.58	2,109.79	6,051.58
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	31,911.14	////////////////////	
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime	1,800.00	////////////////////	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	113,843.01	76,264.68	3,867.19
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	10,330.29	10,330.29	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	17,918.43	17,888.43	30.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	28,248.72	28,218.72	30.00
Gjithsej shpenzimet	1,036,139.66	979,067.73	23,360.79

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguat ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsone Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Furnizim i Zyrave	Albana	Prishtinë	600163373	Specifikacioni	5,956.02
Spote televizive	Buttefly	Prishtinë	600368410	Specifikacioni	46,400.00
Stenda Afishimi	Euro print	Prishtinë	600163860	Specifikacioni	5,050.00
Bileta aeroplani	Euro Koha	Prishtinë	600108353	Specifikacioni	6,194.00
Portale-Reklamim	Indeks Online	Prishtinë	600516225	Specifikacioni	5,000.00
Evente zgjedhore	KD Events	Prishtinë	600602173	Specifikacioni	106,927.30
Rryme elektrike	Kedc	Prishtinë	600678471	Specifikacioni	6,702.22
Spote televizive	Klan Kosova	QT Bregu I Diellit-Prishtinë	600359378	Specifikacioni	12,219.00
Portale-Reklamim	Kosovain.Eu	Prishtinë	600577376	Specifikacioni	19,000.00
Portale-Reklamim	Kosova Press	Prishtinë	600115928	Specifikacioni	7,000.00
Spote televizive	KTV	Sheshi Nena Tereze-	600157722	Specifikacioni	45,627.00

Lidhja Demokratike e Kosoves

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor, 2014

		Prishtinë			
Konferenca /Tubime	LesnaTrade	Prishtinë	600348561	Specifikacioni	9,202.30
Karburante dhe ushqim	Mani Petrol	Malishevë	600069472	Specifikacioni	6,251.95
Portale-Reklamim	Media Works	Prishtinë	600272695	Specifikacioni	10,000.00
Furnizim I Zyrave	Micro	Prishtinë	600085080	Specifikacioni	5,030.15
Qiraja e zyrave	NPB	Prishtinë	600390033	Specifikacioni	10,460.55
Derivate	Petrol-Oti-Sllovenija	Prishtinë	600112370	Specifikacioni	34,119.99
Telefon	PTK	Prishtinë	600016762	Specifikacioni	13,083.42
Spote televizive	RTK	Prishtinë	600294657	Specifikacioni	18,157.00
Spote televizive	TV-21	Prishtinë	600085361	Specifikacioni	10,122.00
Spote televizive	Rrokum TV	Prishtinë	600164165	Specifikacioni	10,000.00
Konferenca/Tubime	Swiss Hotel	Deçan	600119441	Specifikacioni	7,824.90
Spote televizive	Valiant	Prishtinë	600269634	Specifikacioni	5,000.00
Ushqim	Univers	Vermicë-Prizren	600033667	Specifikacioni	11,220.00
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					416,547.80